

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I MINISTRAVE

### VENDIM

Nr. 1030, datë 27.11.2013

#### PËR

#### MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE E TË KRITEREVE TË SIGURISË, PJESA E PARË, PËR KËRKESAT MINIMALE TË PROJEKTIMIT TEKNIK, NDËRTIMIT DHE OPERIMIT TË SISTEMEVE TË TRANSMETIMIT E TË SHPËRNDARJES TË GAZIT NATYROR, TË INSTALIMEVE TË GNL-SË, HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT DHE TË LINJAVE DIREKTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave e të kriterëve të sigurisë, pjesa e parë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, të hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, për operimin e sigurt të sistemeve të gazit natyror, sipas teksteve bashkëlidhur këtij vendimi. Në pjesën e parë të rregullave teknike për industrinë e gazit përfshihen rregulla për sistemin e transmetimit, referuar kodeve të praktikave në vazhdim, si më poshtë vijon:

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G463 “Linjat e gazit me tuba çeliku për presion operimi mbi 16 bar-konstruksioni”.
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G466-1 “Linjat e gazit me tuba çeliku për presion operimi mbi 5 bar-mirëmbajtja”.
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G469 “Metodat e testimit nën presion për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit”.
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G488 “Impiantet për matjen e cilësisë së gazit: projektimi, ndërtimi, operimi”.
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G491 “Stacionet e rregullimit të presionit të gazit për presionet hyrëse deri në e përfshirë 100 bar: projektimi, fabrikimi, instalimi, testimi, komisionimi dhe operimi”.
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G492 “Stacionet e matjes së gazit për një presion operimi deri në e përfshirë 100 bar: projektimi, fabrikimi, ndërtimi, testimi, komisionimi, operimi dhe mirëmbajtja”.
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G497 “Stacionet e kompresorëve”.
- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G497-B1 suplementi 1 “Zonat me rrezik shpërthimi në stacionet e kompresorëve”.

- Rregullat teknike për industrinë e gazit, kodi i praktikave G499 “Parangrohja e gazit natyror në impiantet e gazit”.

2. Rregullat dhe kriteret e sigurisë, të miratuara me urdhrin nr. 666, datë 3.8.2009 të ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për miratimin e rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë, të përkohshme, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”, të jenë në fuqi deri në miratimin e plotë të rregullave e të kriterëve të sigurisë të sistemeve të gazit natyror, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë vendim.

3. Deri në miratimin e plotë të të gjitha rregullave dhe kriterëve të sigurisë për sektorin e gazit, operimi i infrastrukturës ekzistuese së gazit natyror të jetë objekt i rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 191, datë 06.12.2013*